

Karakteristikat e mjeteve rrugore

Viti 2020 *

Tiranë, më 20 Dhjetor 2021: Në botimin “Karakteristikat e mjeteve rrugore”, jepet informacion mbi numrin e mjeteve rrugore që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, të regjistruar me status “Aktiv” ose “Të çregjistruara përkohësisht” në Regjistrin Kombëtar Shqiptar të mjeteve rrugore.

Në vitin 2020, numri gjithsej i mjeteve rrugore me status "aktiv" dhe “të çregjistruar përkohësisht” rezulton 676.811 mjete, nga 628.937 mjete të regjistruara deri në vitin 2019, duke u rritur me 7,6 %.

Mjete rrugore sipas llojit

Nga mjetet rrugore sipas llojit, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë “Autoveturat” (79,7 %), “Automjetet për transport të përzier” (6,9 %) dhe “Motor” (5,0 %), (Tab.1).

Tab. 1 Mjetet rrugore sipas llojit, 2019 - 2020

Lloji i mjetit rrugor	2019	2020	2020/2019 %
Gjithsej	628.937	676.811	7,6
Autoveturë	499.779	539.497	7,9
Automjet për transport të përzier	44.679	46.844	4,8
Motor	30.470	33.899	11,3
Kamion	13.538	13.819	2,1
Autobus	7.493	7.627	1,8
Automjet për transport të veçantë	6.435	6.860	6,6
Ciklomotor	6.590	6.661	1,1
Gjysëm rimorkio	6.137	6.361	3,6
Tërheqës	4.504	4.763	5,8
Automjet për përdorim të veçantë	3.554	3.755	5,7
Makinë bujqësore	1.293	1.743	34,8
Rimorkio për transport mallrash	1.705	1.527	-10,4
Makinë teknologjike	786	874	11,2
Motokarro	825	819	-0,7
Rimorkio për transport të veçantë	559	598	7,0
Kategori të tjera	590	1.164	97,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përllogaritje të INSTAT

Numri i autoveturave deri në vitin 2020, është rritur me 7,9 % në krahasim me vitin 2019, ndjekur nga Automjetet për transport të përzier rritur me 4,8 % në krahasim me vitin 2019.

Mjetet rrugore sipas qarqeve

Numri më i lartë i mjeteve rrugore është regjistruar në qarkun e Tiranës për vitin 2020, duke zënë 36,8% ndaj mjeteve rrugore gjithsej të regjistruara në vend.

Tab.2 Mjete rrugore sipas qarqeve, 2020

Qarku	Mjete rrugore	Autovetura	Autobus	Kamion
Shqipëria	676.811	539.497	7.627	13.819
Berat	26.396	18.867	315	705
Durrës	88.360	72.060	903	1.573
Elbasan	44.466	34.903	556	1.020
Fier	62.523	48.949	609	1.395
Gjirokastrë	15.841	12.203	228	606
Korçë	32.850	25.899	421	893
Kukës	14.405	12.336	162	412
Laç	32.341	26.726	334	710
Peshkopi	16.857	14.140	273	502
Shkodër	47.502	37.854	507	818
Tiranë	249.396	199.196	2.727	4.370
Vlorë	45.874	36.364	592	815

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përllogaritje të INSTAT

Qarku me numrin më të vogël të mjeteve rrugore është Kukësi me 2,1% ndaj mjeteve rrugore gjithsej.

Mjetet rrugore sipas kambios

Autoveturat me kambio “Manuale” zënë pjesën më të madhe (64,9 %) të autoveturave gjithsej që rezultojnë me status “aktiv” ose “të çrregjistruara përkohësisht” deri në vitin 2020.

Tab.3 Mjete rrugore sipas kambios, 2020

Loji i kambios	Autovetura	Autobus	Kamion
Manuale	350.191	6.307	13.099
Automatike	183.624	1.209	525
Semi-Automatike	4.897	89	95
E papërcaktuar	785	22	100

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përllogaritje të INSTAT

Mjetet rrugore sipas vitit të prodhimit

Numri i autovecurave të regjistruara deri në Dhjetor 2020 me vit prodhimi para vitit 2000 ka pësuar rënie me 1,4% ndërsa grupi i autovecurave me vit prodhimi 2011-2020 ka pësuar rritje me 27,3%.

Tab. 4 Autovecura të grupuara sipas viteve të prodhimit, 2019-2020

Viti i prodhimit	2019	2020	2020/2019 %
<2000	140.952	138.979	-1,4
2000-2010	321.808	353.380	9,8
2011-2020	37.019	47.138	27,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përllogaritje të INSTAT

Në nivel më të detajuar, deri në Dhjetor 2020, autovecurat me moshë 11-20 vite përbëjnë 57,7% të numrit gjithsej të autovecurave me status “aktiv” ose “të çrregjistruara përkohësisht”.

Tab. 5 Mjete rrugore të grupuara sipas moshës, 2020

Mosha	Autovecura	Autobus	Kamion
0-2 vite	4.077	14	63
3-5 vite	11.595	84	116
6-10 vite	31.466	299	310
11-20 vite	311.525	3.469	3.251

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përllogaritje të INSTAT

Mjete rrugore sipas markës

Ndër markat kryesore të autovecurave që qarkullojnë në vend, dominojnë marka “Mercedes Benz” (18,2%), e ndjekur nga “Volkswagen” (17,0%) dhe “Daimler Chrysler” (12,1 %).

Tab.6 Mjete rrugore sipas markës, 2020

Marka	Autovecurë	Marka	Autobus	Marka	Kamion
MERCEDES BENZ	98.197	MERCEDES BENZ	3.334	MERCEDES BENZ	7.179
VOLKSWAGEN	91.736	DAIMLER CHRYSLER	626	MAN	1.405
DAIMLER CHRYSLER	65.039	FORD	436	DAIMLER CHRYSLER	918
FORD	53.597	IVECO FIAT	396	IVECO FIAT	774
OPEL	29.805	MAN	287	IVECO MAGIRUS	608
AUDI	27.949	RENAULT	278	VOLVO	510
FIAT	21.720	SETRA	214	DAIMLER BENZ	497
TOYOTA	21.646	VOLKSWAGEN	205	SCANIA	305
BMW	17.802	IVECO	204	DAF	284
RENAULT	15.963	SCANIA	167	RENAULT	254
TË TJERA	96.043	TË TJERA	1.480	TË TJERA	1.085

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përllogaritje INSTAT

Deri në Dhjetor 2020, marka “Mercedes Benz” regjistrohet si marka më e përdorur e autoveturave të regjistruara me vit prodhimi para 2000 dhe viteve 2011-2020. Marka “Volkswagen” regjistrohet si marka më e përhapur e autoveturave me vit prodhimi 2000-2010.

Tab.7 Autovetura sipas markës dhe viteve të prodhimit, 2020

<2000	%	2000-2010	%	2011-2020	%
MERCEDES BENZ	35,1	VOLKSWAGEN	17,1	MERCEDES BENZ	20,2
VOLKSWAGEN	17,6	DAIMLER CHRYSLER	15,5	VOLKSWAGEN	14,8
FORD	7,5	MERCEDES BENZ	11,3	AUDI	7,7
OPEL	5,7	FORD	11,3	FORD	7,2
DAIMLER CHRYSLER	4,3	OPEL	5,8	HYUNDAI	6,8
AUDI	4,0	AUDI	5,3	SKODA	5,7
FIAT	3,8	TOYOTA	5,1	BMW	4,8
RENAULT	3,1	FIAT	4,2	LAND ROVER	4,5
DAIMLER BENZ	2,8	BMW	3,5	TOYOTA	3,4
BMW	2,3	RENAULT	3,1	FIAT	3,4
TË TJERA	13,8	TË TJERA	17,9	TË TJERA	21,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Mjete rrugore sipas lëndës djegëse

Numri më i madh i autoveturave që qarkullojnë në vendin tonë deri në vitin 2020, përdorin lëndë djegëse “Naftë” duke zënë 73,5 % nga 73,3 % deri në vitin 2019, ndjekur nga autoveturat që përdorin lëndë djegëse “Benzinë” me 18,2 % ndaj numrit gjithsej të autoveturave nga 19,4 % që ky grup zinte deri në vitin 2019. Numri i autoveturave që përdorin lëndë djegëse “Naftë” në vitin 2020, është rritur me 8,3 % në krahasim me vitin 2019. Numri i autoveturave që përdorin lëndë djegëse “Benzinë” është rritur me 1,4 % krahasuar me vitin 2019.

Tab.8 Autovetura sipas lëndës djegëse, 2019 - 2020

Treguesi	Nr. Autovetura 2019	Nr. Autovetura 2020	2020/2019 %
Naftë	366.470	396.790	8,3
Benzinë	97.003	98.380	1,4
Benzinë + Gaz	35.630	43.022	20,7
Benzinë + Elektrik	373	552	48,0
Elektrik	123	362	194,3
Gaz	85	219	157,6
Naftë + Elektrik	49	95	93,9
Të tjera hybride	46	77	67,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Numri i autobusëve të regjistruar deri në vitin 2020, që kanë përdorur lëndë djegëse “Naftë” është rritur me 1,8 % krahasuar me vitin 2019.

Tab.9 Autobusë sipas lëndës djegëse, 2019 - 2020

Lënda djegëse	Autobus 2019	Autobus 2020	2020/2019 %
Autobusë Gjithsej	7.493	7.627	1,8
Naftë	7.470	7.602	1,8
Benzinë	5	6	20,0
Benzinë + Gaz	7	8	14,3
Gaz	11	11	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Autovetura sipas vëllimit të motorik

Numri i autoveturave të regjistruara në vitin 2020 sipas vëllimit motorik ≤ 2.000 cc është rritur me 8,6% krahasuar me vitin 2019.

Tab.10 Autovetura sipas vëllimit, 2019 - 2020

Vëllimi motorik	2019	2020	2020/2019 %
<2000	333.740	362.547	8,6
2001-3000	152.929	163.248	6,7
>3000	13.110	13.702	4,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Vëllimi më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse “Benzinë”, është nën 1.399cc duke zënë 52,3% të autoveturave gjithsej. Vëllimi më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse “Naftë”, është 1.400cc-1.999cc duke zënë 53,3%.

Tab.11 Autovetura sipas lëndës djegëse dhe vëllimit, 2020

Vëllimi	Autovetura me Benzinë	Autovetura me Naftë
Autovetura Gjithsej	142.026	396.890
>1.399cc	74.217	24.953
1.400cc-1.999cc	49.696	211.455
>2.000cc	18.113	160.482

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i këtij publikimi është paraqitja e treguesve mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor në nivel sa më të detajuar si: mjetet rrugore sipas llojit, mjete rrugore sipas qarqeve, mjete rrugore sipas kambios, mjete rrugore sipas markës, mjete rrugore sipas lëndës djegëse, autoveturat sipas vitit të prodhimit dhe autoveturat sipas vëllimit motorik.

Në detajimin e autoveturave sipas lëndës djegëse, në grupin “të tjera hybride” janë përfshirë kategoritë “Benzinë + Gaz + Elektrike”, “Benzinë + Elektrik + Hybrid”, “Naftë + Gaz”, “Naftë + Elektrik + Hybrid”.

Përkufizime

Automjete për transport të përzier (ATP) - përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjës, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) - mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Automjete për transport të veçantë (ATV) - mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Kamion - mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave

CC- njësia matëse e vëllimit motorik të mjeteve rrugore e shprehur në centimetra në kub.

Autoveturë - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.

Autobus - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.

Ciklomotor - mjet me motor, me dy, tre ose katër rrota.

Gjysëm rimorkio - mjet motorik i transportit i destinuar për transport pasagjerësh dhe mallrash.

Makinë bujqësore - mjet motorik me rrota ose me zinxhir i destinuar për t'u përdorur në bujqësi e pylltari, për transport të mallrave bujqësore.

Motokarro - mjete me tri rrota, të destinuar për transport malli. Mund të kenë deri në dy ndenjës për njerëzit që merren me transportin, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit.

Tërheqës - Mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove.